

PKR.nr.478/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit, anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtaret Shashivar Hoti dhe Naime Jashanica, me bashkëpunorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.G.për shkak të veprës penale Raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë Rënda, PP.nr.487/02 të datës 03.08.2006, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurorja e shtetit Besa Limani, i akuzuari B.G.me mbrojtësin av.M.N. sipas autorizimit, me dt. 01.02.2018 mori dhe shpalli publikisht:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

BG., nga i ati E., e ëma L., , e gjinisë C., i lindur me dt. ..., në P., me vedbanim tani me vendbanim në fshatin “Sh.” K-P., me qëndrim të përhershëm në A., nr.... C.G., mënife ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i ... fëmiu, punëtor, punon me p., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, Me nr. personal

LIROHET NGA AKUZA

SE: me dt.27.03.2001 rreth orës 22:30 në rrugën për në Mitrovicë, në afërsi të fshatit O. I dëmtuari K.G. nga fshati B., Komuna e O. pasi që e ka ndalur veturën e tij për te ia rregulluar dritat, të pandehurit me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ose tjetrit ti sjellin pa të drejtë përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë shkuar me veturën e tyre “Jugo” të armatosur me pushkë automatike AK-47 ne kanë rrethuar dhe ia kanë thyer xhamat e derës në anën e ngasësit dhe iu kanë kërcenuar duke ia mbajtur tytën e automatikut në kokë se do ta vrasin nëse nuk ju jep të gjitha të hollat që I kishte me veti dhe me këtë rastë ia kanë marr 400 DM, duke iu kërcënuar se nëse I tregon ndokujt do ta vrasin,-

- me këtë kishte për të kryer veprën penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barren e buxhetit të kësaj gjykatës.

I dëmtuari K.G. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në contest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritë aktakuzë PP.nr.478/02 të datës 03.08.2006 kundër të akuzuarit B.G.për shkak të veprës penale raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë pas leximit të aktakuzës , me rastin e deklarimit të të akuzuarit lidhur me çështjen e fajësisë në kuptim të nenit 326 parag 1 të KPPRK-së, i akuzuari B.G. ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, dhe duke qenë se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për aktakuzën në fjalë, gjykata duke u bazuar në nenin 327 parag 1 nënparag 1.2 të KPPRK –së, ka vendosë që seanca e shqyrtimit gjyqësorë të vazhdoj me prezentimin e provave.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, prokurorja e shtetit Besa Limani në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi mbetem pranë aktakuzës së ushtruar kundër të pandehurit B.G.sepse konsideroj se është vërtetuar gjendja faktike se i njëjti ka kryer veprën penale që i vihet në barrë në kohë ,vend dhe mënyrë siq është përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze. Kjo gjendje faktike është vërtetuar me dëshminë e të dëmtuarit K.G. të dhënë në shqyrtim gjyqësorë i cili në mënyrë bindëse ka theksuar se ka identifikuar automjetin me të cilin ka qenë i pandehuri natën kritike dhe ka kryer veprën penale me dy persona të tjerë, automjeti ka qenë i tipit Jugo me ngjyrë të kuqe me xhama të zi mbrapa, ndërsa që në deklaratën e dhënë në polici ka theksuar se ka arrit të ja marr gjysmën e numrave të tabelave të cilat ishin 114 KS, dhe se edhe gjatë ballafaqimit dhe identifikimit nga ana e trupit gjykues, i dëmtuari ka theksuar se sa i kujtohet ka qenë B.G.njëir nga personta, mirëpo meqenëse ka kalu një periudhë e gjat kohore, i njëjti në atë kohë ka qenë më i dobët dhe se ky person ka qendruar në anën e djathtë të veturës me të cilën natën kritike është kryer vepra penale. Andaj i ka propozuar trupit gjykues që i njëjti të shpallet fajtorë dhe të denohet sipas ligjit. Gjat matjes së denimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapra me ligj.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.G.av.M.N. në fjalën përfundimtare ka deklarua se pasi janë administruar gjitha provat si ato materiale dhe formale nga prokuroria, nuk është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë në raport me të mbrojturin tij për shkak se me asnjë provë nukë shtë vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Më tutje ka shtuar se sa i përket dëmtuar I dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit K.G., i njëjti në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se ndër ata tre persona që e kan grabitur ka mundur ta shoh pjesërisht vetëm fytyrën e një personi që quhet N.G., ndërsa për dy persona të tjerë ka deklaruar se nuk ka mundur ti përshkruaj dhe ti shoh për shkak se gjat gjith kohës ka qenë i kërcënuar nga një person me automatik, nuk ka guxuar që ta ngrit kokën. Po ashtu ka shtuar se gjykata nuk ka administruar asnje prove materiale e cila do

të vërtetonte se i mbrojturi tij ne qfardoforme ka qenë i implikuar në kryerjen e kësaj veprë penale dhe se pikërisht në mungesë të provave gjykata e atëhershme e Qarkut në Prishtinë si dhe gjykata Supreme e Kosovës, dy të bashkakuzuarit e tjerë i ka shpall të pa fajshëm në mungesë të provave. Andaj, i ka propozuar trupit gjykues që pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre të akuzuarin B.G.ta liroj nga akuza për shkak se asnjë provë nuk e vërteton se I njejt i ka kryer veprën penale për të cilën edhe është akuzuar.

I akuzuar B.G.e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

Gjykata pas vlerësimit të provave të proceduar një ga një dhe të gjithave së bashku nuk ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit .

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat personale dhe materiale të propozuara nga palët në procedurë, dhe atë dëshmit të dëmtuarit K.G., si dhe provave material lista mbi marrjen e sendeve dt; 30.01.2001 dhe fotodokumentacionin që gjinden në shkresa të lëndës.

Dëshmitari/i dëmtuari K.G. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nw kohwn kur ka ndodhur ngjarja ka qenë polic hetues në kuadër të stacionit nr.II, ndwrsa qw tani wshw mbikqyrës i hetimeve në depratamentin e hetimeve kunër krimit të organizuar dhe se natën kritike ka qenë vetëm duke shkuar në shtëpi me veturën golf II rreth orës 22:30 min, dhe pasi që ka pas problem me drita, e ka ndal veturen skaj rrugës e cila nuk ka qenë e ndriqar po ka nxe hëna, për të i rregulluar siguresat e dritave dhe për një moment derisa ka qenë i kërrusur duke shiqur siguresat ka vërejt se xhami i derës së shoferit ka kërsitur pa pritmas dhe automatiku i është vendosur në qafë, ka qenë tre persona, dhe të njejtit kanë kërkuar para nga ai, të njejtit kanë pasur të vendosura xhempera në kokë, dhe shumë pak ka mujt me i pa në fytyrë, ndërsa që personi i cili i ka vendos automatikun në qafë, ka qenë afër derës së shoferit ku ka qenë ai, ndërsa njëri ka qenë pak ma larg, i treti në anën e djathtë të veturës dhe se ju ka dhënë aq sa ka pasur në xhep dhe se në xhep te pantollave i ka pasur 300 (treqind) DM marka gjermane, ndërsa që ata I kanë thene “dheze kerrin dhe mos gabo as mu kthy” ndërsa që pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në polici ku kishte deklaruar shumë prej 400 DM është përgjigjur se nuk I kujtohet. Më tutje ka shtuar se duke u larguar me veturë ka vërejt në retrovizor se ka qenë një veturë ‘jugo’ me ngjyrë të kuqe dhe ka pas një bagazh lart dhe se ata tre persona kan hy në atë veturë, e cila ka qenë e parkuar në rrugën e fshatit “O.” dhe rruga ka qenë më zhavor, ndërsa që ndëkohë derisa ka qenë në qytete gjatë orarit të punës e ka vërejt veturën ‘jugo’, e cila në bazë të përshkrimit ka qenë ajo veturë me të cilën është kryer vepra penale, më ç’rast ai ka shkuar pas veturës që me vërejtë se në cilin drejtim po lëviz ajo veturë, dhe kur ka mbërri ajo veturë tek ura e F.K., është nis në drejtim të O. dhe është ndal tek vullkanizeri në kthesë, nga e cila kanë dalur dy persona dhe një person tjetër që ka dal prej puntorisë aty. Më tutje ka shtuar se ka njoftu shefin e hetimeve se e ka pa veturën me të cilën atë natë tre persona që e kanë kryer grabitjen, përçka është ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici ku kishte deklaruar se “...ku në hyrje të fshatit e ndeza dritën reflektuese dhe i ndalova të dyshimitit...pasi që i kontrollova të dyshimitit atyre ua morra dokumentat dhe u thash se së bashku me veturë të më shoqërojnë për në stacion”, është përgjigjur se ndoshta ka qenë ashtu, nuk i kujtohet.po ashtu ka shtuar se sa i përket përshkrimit të personave ka theksësuar se sa i kujtohet se njëri prej tyre ka qenë më i shkurt me trup, i cili edhe ja ka vendosur automatikun në

qafë, kurse njëri prej të dy të tjerëve ka qenë më i gjatë me trup dhe fizikisht më i dobët me trup, ndërsa të tretin nuk ka pasë mundësi me pa mirë sepse nuk kam mujt me e lëvizë kokën, për shkak se ata më kanë paralajmëru se për çdo lëvizje mundësh me pësu. Më tutje sa i përket numrit të targës së automjetit pasi që ka deklaruar se targat nuk i kom pa, është ballafaqur me deklaratën e dhën në polici ku kishte deklaruar se ka bërë identifikimin e targave 114-KS, është përgjigjur se sa i kujtohet të nesërmen e ka bërë identifikimin e veturës me targa.

Nga lista mbi marrjen e sendeve dt; 30.01.2001 vërtetohet se në puntorin e tani të dënuarit Xh.A. autoservisi "V." është gjetur dhe konfiskuar një revole e tipit "Zastava" e kal.7.65 mm me nr.serik 265429 si dhe 27 fishek të këtij kalibri, ndërsa që në fotodokumentacionin që gjinden në shkresa të lëndës, shfaqet foto e tani të akuzuarit B.G. pasi që ishte arrestuar nga organet e ndjekjes.

Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë në të cilën u administruan të gjitha provat materiale, të njejtat i vlerësoi veç e veç dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, gjykata ka vlerësuar se nuk është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vlerësuar dëshmin e dëshmitarit **K.G.** mirëpo të njëjtës ja fali pjesërisht besimin dhe atë vetëm lidhur me pjesën që ka të bëjë me faktin se natën kritike i njëjti ishte grabitur nga persona të panjohur, mirëpo me asnjë pjesë të dëshmis së tij qoft për llojin e veturës apo për përshkrimin e personave nuk mund të vërtetohet se njëri nga personat ishte tani i akuzuari B.G., dhe se iu dëmtuari gjithë lidhmerin e të akuzuarit me ngjarjen në natën kritike e lidhë me veturën e tipit "Jugo" të cilën e kishte identifikuar vetëm në bazë të ngjyrës apo tipit të veturës, ndërsa që më vonë, pasi qe e ka parë veturën e tipit "Jugo" ka përmendur edhe numrin e parë të targës së veturës 144 KS..., po ashtu duke qenë se koha kur ka ndodhur rasti ka qenë natë, dhe siq ka pohuar vetë i dëmtuar nuk ka pasur ndriqim, përveq dritës së hënes, dhe faktit që dy persona kanë pasur xhamper të vendosur në kokë dhe se të tretin siq ka deklaruar dëshmitari nuk ka mundur ta shohë, deklarimi dëshmitarit se i akuzuari B.G. është njëri nga personat që i kishte grabitur atë natë, është si i tillë jo i bindshëm, pasi që të gjitha rrethanat që pemend e vën dyshim mundësin që kishte për ta identifikuar të njëjtin në momentin kritikë.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe listën mbi marrjen e sendeve dt; 30.01.2001 dhe fotodokumentacionin që gjinden në shkresa të lëndë, mirëpo nga të cilat nuk ka mundur të vërtetoj asnjë rrethan relevante në drejtim të përgjegjësis penale për të tani të akuzuarin B.G..

Meqenëse nuk është provuar se i akuzuari B.G. ka kryer veprën penale Raste të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, gjykata konform nenit 364 parg 1 nënparg 1.3 të KPPRK-së e ka liruar ka aktakuza.

Në bazë të nenit 454 parg 1 të KPPRK-së është vendosë që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore.

Vendimi që i dëmtuari K.G. të udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkeses pasuroro - juridike është marr konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Nga se u tha më lart është vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.478/13, të dt: 01.02.2018**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri**

**Bashkëpunatori profesional,
Driton Berisha**

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.